dekoll®
PREMIX PER L'EDILIZIA

Produkt në përputhje me standardin:
EN 12004
Produkte për veshje dekorative me bazë organike për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm mbi mure, tavane dhe kolona.

TECHNICAL DATA SHEET Issue: 1 Version: 2

S- FLEX C2TES1 GRI / BARDHE

PERSHKRIMI

Ngjitës per pllaka me bazë Cimento, me performance te larte, pa rreshkitshmeri vertikale , kohe e gjate pune dhe me elasticitet te larte. I përbërë nga rëra mermeri cilësore me granulometri të perzgjedhur,polimer sintetike ne perqindje te larte dhe aditivë cilesore. Produkti ka karakteristika të shkëlqyera në fleksibilitet dhe punueshmëri ,cka e bën këtë ngjitës ideal për ngjitjen e te gjitha llojeve te pllakave. Kur përzihet me ujë, formohet një mase kremoze, homogjene dhe shumë tiksotropik, i cili përhapet lehtë me mallë të dhëmbëzuar dhe mundëson mbulim të mirë të pjesës së pasme të pllakës.

KLASIFIKIMI SIPAS STANDARTIT

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C), me forcë ngjitëse te permiresuar (2) , rezistent ndaj rreshkitjes (T), kohë punueshmërie e gjatë (E) dhe i deformuesem/elastik (S1) .
I klasifkuar si ngjitës C2TES1 sipas standartit EN 12004.
S-FLEX ka emetime shumë të ulëta të VOC-ve, (komponimeve organike të avullueshme), duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së aplikatoreve. sipas kerkesave EC1 Plus.

KARAKTERISTIKAT

1. Ngjitje e shkëlqyer dhe performance e përmirësuar mbi suportet më të përdorura në ndërtim.
2. Bardhësi e theksuar për variantin e bardhë te produktit
3. Punueshmëri shumë e mirë, përhapje e lehtë dhe kontakt i plotë me pjesën e pasme të pllakës.
4. Pa rrëshqitje vertikale, edhe gjatë vendosjes së pllakave në mur.
5. Kohë e gjate pune dhe korrigjimi për aplikim më të saktë.
6. Rezistencë e lartë ndaj lagështisë, kushteve atmosferike dhe ndryshimeve normale të temperaturës.
7. I përshtatshëm për pllaka me format të madha, (5 – 150 cm).
8. Mund të aplikohet në trashësi deri në 15 mm
9. Për shkak të klasifikimit S1, rekomandohet dhe për sipërfaqe me kërkesa më të larta deformimi sesa një C2TE standard.

FUSHA E APLIKIMIT

I pershtatshem per ngjitje pllakash qeramike, gres porcelan, mermer, gur natyral, mozaik dhe tulla xhami.
Aplikime në ambiente të brendshme dhe të jashtme , fasada, tarraca , ambiente me lagështi dhe zona ku kërkohet fleksibilitet më i lartë., dysheme me ngrohje qendrore ose situata ku pritet lëvizje termike e kontrolluar.
Suportet duhet te jene me bazë çimento: beton, llaç çimentoje, suva çimentoje dhe veshje hidroizoluese të përshtatshme.
I pershtatshmem dhe per ngjitje pllakash te dimansioneve te medhe 5-150 cm, duke respektuar mbulimin e plotë dhe teknikën e dyfishtë për formate të mëdha, për ambjente industriale, për suporte të valëzuara dhe të paqëndrueshme (kjo si rezultat i elasticitetit të lartë). (Për banjo , rezervuarë, tarraca të ekspozuara ose zona me kërkesa të larta ndaj ujit, produkti duhet të përdoret si pjesë e një sistemi të përshtatshëm hidroizolimi dhe aplikimi, sipas projektit teknik)

MENYRA E PERGATITJES SE PERZIERJES

Përzieni 7-8 litra ujë të pastër me 25 kg S- FLEX, përzieni masen e krijuar me një përzierës elektrik deri sa të formohet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përziejeni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë në kushte normale temperaturash (23°C).

dekoll®
PREMIX PER L'EDILIZIA

Produkt në përputhje me standardin:
EN 12004
Produkte për veshje dekorative me bazë organike për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm mbi mure, tavane dhe kolona.

TECHNICAL DATA SHEET Issue: 1 Version: 2

S- FLEX C2TES1 GRI / BARDHE

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Dysheme tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. dhe te sperkaten me uje.

APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Pllakat vendosen mbi ngjitësin e freskët duke ushtruar presion të mjaftueshëm për të siguruar kontakt të plotë. Për pllaka me format të madh, sipërfaqe të jashtme, fasada, dysheme me ngarkesë ose zona me prani uji, rekomandohet aplikimi i ngjitësit edhe në pjesën e pasme të pllakës për mbulim maksimal. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje ţlmi. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe njëherë malla mbi kollë. Nuk këshillohet që pllakat të vendosen me fuga të puthitura. Pllakat vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme me dimensionet e tyre.

KUJDES!

1. Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund te ndryshojne karakteristikat e punimit te produktit (ngadalsim ose pershpejtim ne tharje te produktit).
2. Për formate pllakash shumë të medha,aplikoni shtrim te dyţshtë të kollës në pllakë dhe bazament.
3. Mbroni bazamentin për të paktën 24 orë pas aplikimit të ngjitësit, nga shirat e rrëmbyer si dhe nga ngricat dhe rrezet e forta te diellit.
4. Për formate të mëdha pllakash vendosja e fugës do të bëhet 3-5 ditë pas ngjitjes vetëm nëse është bërë hidroizolimi
5. Mos e aplikoni mbi suporte të paqëndrueshme, të pamaturuara, me pluhur, vaj, yndyrë ose mbetje që pengojnë ngjitjen.
6. Mos e përdorni drejtpërdrejt mbi dru, metal, PVC, gomë, linoleum ose suporte shumë të lëvizshme pa sistem të përshtatshëm paraprak..
7. Mos tejkaloni raportin e rekomanduar të ujit dhe trashësinë maksimale të aplikimit.
8. Për aplikime speciale, fasada të larta, pishina, rezervuarë ose sipërfaqe me ngarkesa të larta, rekomandohet verifikim teknik dhe sistem i plotë aplikimi

dekoll®
PREMIX PER L'EDILIZIA

Produkt në përputhje me standardin:
EN 15824
Produkte për veshje dekorative me bazë organike për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm mbi mure, tavane dhe kolona.

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1 Version: 2

S- FLEX C2TES1 GRI / BARDHE

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	E bardhë/Gri
Konsumi për formate të vogla:	2-3 kg/m²
Konsumi për formate të mëdha:	4-5 kg/m²
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa Vëllimore:	1.6-1.7 gr/cm³
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E
Ujë për përzierje:	6 litra ujë për 25 kg
pH i përzierjes:	13
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Koha e korigjimit:	35 min
Mbushja e fugave në mure:	Pas 8 deri 12 orësh
Mbushja e fugave në dysheme:	Pas 24 orësh
FN* pas 28 ditësh:	≥1 N/mm²
FN* pas zhytjes në ujë:	≥1 N/mm²
FN* pas reaksionit nga ngrohja:	≥1 N/mm²
FN* pas cikleve ngrirje-shkrirje:	≥1 N/mm²
FN* pas 30 min:	≥0,5 N/mm²
I shkelshëm:	Pas 24 orësh
Rrëshkitshmëria:	≤0,5 mm
Deformueshmëria:	≥S1

Address: Autostrada Durrës-Tiranë, Km5, Durrës, www.dekoll.al; info@dekoll.al

*FN- Forca ngjitëse